



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME RREGULLATORE  
DREJTORIA E BASHKËQEVERISJES

Nr. 18132 prot.

Vlorë, më 08.09.2026

PROCESVERBAL KONSULTIMI PUBLIK

RAJONI 4

DATË 27.08.2026 ORA 17:00

**Tema:** Konsultimi i Buxhetit Afatmesëm 2027-2029 dhe planifikimi për projekt buxhetin e vitit 2027 për Bashkinë Vlorë.

**Baza ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2014 “Për njoftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funksionimit të Bashkisë; si dhe Kalendarit të Konsultimit Publik nr.16533 prot, datë 13.08.2026.

**Marrin pjesë:**

*Kryetare e Bashkisë Vlorë znj.Brunilda Mersini, Kryetarja e Këshillit Bashkiak Vlorë-znj. Elpiniqi Mërkuri, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Irena Toshkallari, Nënkryetarja e Bashkisë – znj. Klea Lalo, Kryetare e Rajonit znj.Ledja Shollaj, Drejtor i Financës – z. Hiqmet Haxhaj, Ministre- znj. Erjona Ismaili, anëtar të këshillit bashkiak, drejtorë të Administratës së bashkisë Vlorë, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznesi.*

( Në takim morrën pjesë 25 persona.)

**Takimin e hap Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Ju falenderojmë për kohën që na kushtoni dhe për mundësinë për të bashkëbiseduar me ju.

Në këtë rajon dinamika është e madhe, pasi gjatë kësaj periudhe janë realizuar dhe vijnë të realizohen një sërë investimesh të rëndësishme.

Një nga problematikat që kemi pasur ka qenë menaxhimi i mbetjeve. Për këtë çështje ka nisur zbatimi i kontratës, e cila parashikon kapsulimin e të gjitha mbetjeve në zonë. Gjithashtu, pjesa e aviacionit do të rehabilitohet dhe do të mbillet, duke krijuar një hapësirë më të gjelbër dhe më të përshtatshme për komunitetin.

Kemi gjithashtu projektin për ndërtimin e një parku lojërash, i cili do të shoqërohet me një ambient të gjerë sportiv. Në këtë kuadër, kemi menduar edhe ndërhyrje për krijimin e një parku lodrash pranë shkollës “Marigo Posio”, si dhe për përmirësimin e hapësirave publike për fëmijët.

Vijon puna për pastrimin e kanalit të Naunkës dhe lirimin e hapësirave për të garantuar funksionimin e plotë të tij. Po në vazhdimësi po punohet edhe për kanalën e Siavit.

Një tjetër ndërhyrje e rëndësishme do të jetë ajo në zonën e stacionit të trenit, ku synojmë përmirësimin dhe sistemimin e hapësirës.

Sektori i arsimit do të jetë një nga objektivat kryesorë të buxhetit. Shkolla “Marigo Posio” është drejt përfundimit. Në vëmendjen tonë janë edhe shkolla “Jani Minga”, si dhe kopshtet nr. 11 dhe nr. 13. Gjithashtu, parashikohen ndërhyrje edhe në rrugën “24 Maji”.

Sa i përket problematikës së furnizimit me ujë, nuk kemi kompetencë vendimmarrëse mbi këtë çështje, por ajo mbetet një problematikë e rëndësishme që kërkon vëmendje dhe bashkëpunim institucional.

Të gjitha këto ndërhyrje synojnë përmirësimin e cilësisë së jetës së komunitetit, dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

Fjala është për ju.



**Banor i lagjes “24 Maji”:** Nevojitet një lulishte, pasi po humbet besimi te pushteti vendor. Problem mbetet edhe rruga “Mehmet Alemi”, ku mungojnë trotuaret dhe krijohen vështirësi e rrezik për lëvizjen e këmbësorëve

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Nevojitet prishja e murit të banesave.

**Banor:** Ju falenderoj për punën tuaj, por problem mbeten ujërat e zeza dhe ndriçimi.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Jemi duke u furnizuar ne lidhje me ndriçimin

**Banor:** Kanali ekzistues duhet të mbulohet. Përpara pallatit, në Transballkanike, rruga duhet të shtrohet.

**Banor:** Faleminderit për investimet e realizuara në zonën e Stacionit të Trenit.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Jemi duke përgatitur projektin për stacionet terminale të autobusëve dhe për linjën e trenave.

**Theodhori Driza:** Ju komplimentoj për punën intensive. Problem mbeten rrugët, punimet e kryera duhet të inspektohen. Ka nevojë për ndërhyrje në palestrat e shkollave dhe në palestrën e qytetit. Gjithashtu, nevojitet buxhet për shkollën “Jani Minga”.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Është hartuar projekti për shkollën “Jani Minga”.

**Banor:** Problem mbetet furnizimi me ujë të pijshëm, vuajmë mungesën e ujit në zonën pas Hotel Tozo. Gjithashtu, ka nevojë për ndërtimin e banjove publike.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** I gjithë parkimi i Skelës do të ketë 7–8 banjo publike.



**Ministrja znj. Erjona Ismaili:** Përshëndetje. E vlerësoj kryetaren për vëmendjen që i ka kushtuar Rajonit 4. Kemi përgatitur një listë problematikash, një pjesë e të cilave janë prioritare. Çdo problem që kemi paraqitur ka marrë vëmendje dhe trajtim. Ndriçimi u realizua. Shkolla “Ibrahim Kushta” të ketë vëmendje në buxhet, veçanërisht për fasadën dhe tualetet. Ka nevojë për pastrim të thellë të bimësisë së egër. Kërkohej krijimi i lulishteve të vogla midis pallateve, si dhe ndërhyrje në rreth 200 metra rrugë.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Kemi pastruar Pyllin e Sodës dhe nuk lejojmë krijimin e pikave të hedhjes së mbetjeve në pyll. Jemi vazhdimisht të angazhuar në pastrimin dhe monitorimin e zonave problematike.

**Banor i pallatit 1300:** Ju falenderoj për punën tuaj. Kërkohej më shumë vëmendje për pjesën e këmbësorëve.

**Kryetare e Bashkisë Vlorë, znj. Brunilda Mersini:** Pallati është drejt përfundimit.

Faleminderit!

Konceptoi: Aurora Kamberaj  
Koordinatore për njoftim dhe Konsultim Publik

